



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gashi EG shpk" të datës 31.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gashi EG shpk" të datës 31.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Gashi EG shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 31.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1.


Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi ynë ankimor ka të bëjë me pozicionet e paramasës me numër 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 44, 71, 72, 73, 74, 75, 107, 108, 109, 141.

AK lidhur me këto pozicione ka përcaktuar specifika konkrete të cilat i ka prezantuar edhe përmes fotografive. Si shembull mund të marrim pozicionin vijues:

Figura 10



Në pyetjet sqaruese, AK është përgjigjur se lejimi i produkteve të ngjashme (pra ekuivalente apo më të avancuara), do të nënkuptonte ndryshimin e dimensioneve të produkteve. Mirëpo në rastin konkret nuk është problemi vetëm te dimensionet sepse produktet mund të realizohen sipas dimensioneve që dëshirojmë. Problemi në rastin konkret qëndron te dizajni i produkteve përkatësisht forma e tyre. Të gjitha produktet që janë kërkuar në paramasë në pozicionet e sipërcituara prodhohen ekskluzivisht nga një prodhues i caktuar i cili e ka të mbrojtur dizajnin industrial. Pra nuk ekziston asnjë mundësi ligjore që të prodhohen produktet identike sikurse kërkohen në paramasë nga prodhues të tjerë.

Përndryshe një situatë e tillë ka përgjigjen adekuate në RRPP përmes nenit 19.6 ku thuhet se *“Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët **ose e barasvlershme/ekuivalente**”*.

Në rastin konkret kërkohet nga AK që për pozicionet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 44, 71, 72, 73, 74, 75, 107, 108, 109, 141 (për të cilat AK kërkon edhe autorizim, katalog dhe garancion nga prodhuesi), që përveç produkteve me dizajnin dhe formën e prezantuar në paramasë, **të lejoj edhe dorëzimin e produkteve të ngjashme respektivisht ekuivalente apo më të avancuara.** Natyrisht kjo do të vlej vetëm sa i përket dizajnit industrial – formës dhe jo sa i përket dimensioneve të përcaktuara nga AK në paramasë.

Në të kundërtën formulimi i kërkesave në paramasë nëse nuk korrigjohet, kjo do të jetë në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP lidhur me nenin 19.6 të RRPP pasi që po favorizohet drejtpërdrejtë vetëm një prodhues i cili ka pronësinë e vetme ligjore mbi dizajnin përkatës industrial të produkteve për të cilat po bëhet fjalë.

Vlen të shtohet se titulli i kontratës është “Mirëmbajtja e mobilerise urbane”, mirëpo në paramasë ka shumë pak pozicione të mirëmbajtjes dhe shumica janë pozicione të punës dhe të furnizimit jo të mirëmbajtjes.

Lidhur me pretendimet ankimore, përmes nenit 19.6 të RRPP është përcaktuar si vijon: “Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët ose e barasvlershme/ekuivalente”. Nga analizimi i DT dhe i paramasës është gjetur se produktet e kërkuara sipas pozicioneve përkatëse nuk lejojnë fare ekuivalencë por përcaktojnë dizajn industrial konkret dhe specifik. Prandaj pretendimet janë gjetur si të bazuara dhe AK duhet të lejoj që për pozicionet përkatëse OE të ofertojnë edhe me produkte ekuivalente sa i përket formës apo dizajnit industrial ndërsa dimensionet mund të mbesin ashtu sikurse janë përcaktuar me DT.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik”.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.